

NJOFTIMET E ZYRAVE TË SERBISË

- Zyra e Beogradit: 11000 Beograd, Kumodraska 162, tel.: +381-11-3970-127. Orari i hapjes: të hënën, të martën dhe të enjten 12.00-19.30, të mërkurën dhe të premten 9.00-16.30.
- Zyra e Nisit: 18000 Niš, Učitelj Tasina 13/1., tel.: +381-18-514-130, +381-18-514-131. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 11.00-19.00, në ditët e tjera të punës 9.00-17.00.
- Zyra e Horgosit: 24410 Horgoš, Bartok Béla 80. tel.: +381-24-792-195. Orari i hapjes në ditët e punës: 8.00 - 16.00. Drejtori i rajonit: Branislav Rajic.

– Forever Living Products Beograd na ofron shërbimet e mëposhtme: bërje porosish në telefon - Telecenter. Numri i telefonit: 011/309-6382. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12: 00-19.30, në ditët e tjera të punës 9:00-16.30. Në rastin e porositjes në telefon malli shkon tek adresa që gjendet në numrin e kodit dhe paguhet kur merret në dorë.

- Shpenzimet e postës paguhen sipas kursit të PTT Serbisë të ditës që ndodh shërbimi, por FLP-ja e Beogradit i paguan vetëm nëse porosia e bërë në një numër kodit e kalon 1 pikë krediti.
- Nuk mund të bëhet hyrje nëpërmjet telefonit.
- Porositë telefonike merren në shqyrtim deri në datën 25 të muajit, pas kësaj date mund të porosini vetëm personalisht në zyrën tonë.
- Edhe në zyrën e Horgosit dhe Nisit mund të blihen materiale reklamash dhe gjithë llojet e formularëve. Distributorët tanë mund të blejnë edhe fletat e regjistrimit dhe formularët për ndryshimin e të dhënave.

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Serbisë:

Dr. Biserka Lazarević dhe Dr. Predrag Lazarević: +381-23-543-318. Ata i presin thirrjet tuaja për konsultim të martën në orën 13.00-16.00 dhe të premten në orën 14.00-16.00. Dr. Božidar Kaurinović të mërkurën dhe të enjten në orën 12-14 pret thirrjet tuaja për konsultime në numrin e telefonit +381-21-636-9575.



NJOFTIMET E ZYRËS SË MALIT TË ZI

- 81000 Podgorica, Serdara Jola Piletića br. 20. tel: +381-081-245-402, tel/fax: +381-081-245-412. Drejtori i rajonit: Aleksandar Dakic

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Malit të Zi:

Dr. Laban Nevenka: +381-69-327-127



NJOFTIMET E ZYRAVE TË BOSNIA-HERCEGOVINËS



Zyra e Bijelinës

- Zyra e Bijelinës: 76300 Bijeljina, Trg D. Mihajlovića 3., tel: +387-55-211-784, +387-55-212-605, fax: +387-55-221-780. Orari i hapjes në ditët e punës: 9.00-17.00.

- Zyra e Banja Lukas: 78 000 Banja Luka, Duško Koščica u. 22., tel.: +387-51-228-280., fax: +387-51-228-288. Drejtori i rajonit: Dr. Slavko Paleksic. Orari i hapjes: në ditët e punës 9.00-16.30
- Zyra e Sarajevës: 71000 Sarajevo, Akifa Seremeta do. 10., tel.: +387-33-760-650, +387-33-470-682, fax: +387-33-760-651.. Orari i hapjes: të hënën, të enjten, të premten: 09.00-16.30, të martën, të mërkurën: 12.00-20.00. Në çdo të shtunë të fundit të muajit organizojmë një Ditë Suksesi Mini në zyrën e FLP-s. Drejtori i zyrës: Enra Hadžović Në zyrat e Forever Living Products të Bosnias porositë telefonike mund të bëhen në numrat e mëposhtëm (regjistrimi i shpërndarësve të rinj nuk mund të bëhet nëpërmjet telefonit): +387-55-211-784, Bijelinë dhe +387-33-760-650 Szarajevë.

Njoftim i zyrës së FLP-s së Sarajevës

– Nga shtatori në shërbimin tonë është këshilltarja dhe specialistja mjekje nga Bosnia-Hercegovina Dr. Esmā Nisic, me të cilën mund të kontaktohem në numrin e telefonit: +387-62-367-545 gjatë ditëve të punës në orarin: 18:00 – 21:00.

– Këshilltarja dhe specialistja jonë mjekje çdo të mërkurë mban konsultime në zyrën e Sarajevës në orën 17:00 – 19:30.

– Në rastin e porosisë telefonike pagesa bëhet kur merret malli. Nëse vlera e porosisë është më e madhe se 1 pikë krediti, atëherë shpenzimet e transportit paguhen nga distributori.

NJOFTIMET E ZYRAVE TË KROACISË



• Zyra e Zagrebit: 10000 Zagreb, Trakošćanska 16.ű

Njoftojmë punonjësit dhe konsumatorët tanë se zgjatëm orarin e hapjes së zyrës së FLP-s së Zagrebit: të hënën dhe të enjten: 09:00 - 20:00; të martën, të mërkurën dhe të premten 09:00 - 17:00. Tel: 01/ 3909 770; Fax: 01/ 3704 814. Porositë telefonike: 01/ 3909 773.

• Zyra e Splitit: 21000 Split. Križine 19. tel.: +385-21-459-262. Orari i hapjes: të hënën 12.00-20.00; të martën, të mërkurën, të enjten dhe të premten 09.00-17.00. Drejtori i rajonit: Dr. Molnár László

Porosia telefonike: 01/3909 773. Në rastin e porosive me vlerë më të madhe se 1 pikë krediti, çmimi i transportit paguhet nga FLP-ja. Leksionet rreth produkteve dhe marketingut organizohen të hënën, të martën, të mërkurën dhe të enjten nga ora 17 në zyrën qendrore. Orari i hapjes së qendrës: të hënën dhe të

enjten 12:00 – 20:00, të martën dhe të mërkurën 11:00 – 19:00, dhe të premten 09:00 – 17:00. Takimet mund të lihen në numrin telefonik 01/ 3909 773.

NJOFTIM I RËNDËSISHËM: nga 1 marsi nëse blini produkte me vlerë më të madhe se 1500 kuna, apo përdorni shërbimet e sallorit kozmetik, me kartën tuaj DC mund të paguani edhe me këste (2-3 këste). Shfrytëzoheni mundësinë e blerjes me ulje. Për detajet interesohuni tek sponsori juaj ose tek punonjësit e zyrës.

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Kroacisë:

Dr. Ljuba Rauski Naglic: +385-915176510

(në ditët e keqe ndërmjet orës 16.00 dhe 20.00)

Dr. Eugenija Sojat Marencic: +385-915107070



NJOFTIMET E ZYRAVE TË SLLOVENISË

• 1236 Trzin-Ljubljana, Borovec 5., tel: +386-1-562-3640.

Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00, të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00.

• Adresa e magazinës së Lendavait: Kolodvorska 14., 9220 Lendava. tel.: +386-2-575-12-70, Fax: +386-2-575-12-71, e-mail: forever.living@siol.net.

Orari i hapjes: të hënën 12.00-20.00, të martën dhe të premten 09.00-17.00. Drejtori i rajonit: Kepe Andrej

Numri i Telecenterit (ku bëhen porositë telefonike) është: 01/563-7501

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Sllovenisë:

Dr. Arbaiter Miran: +386-41420788, Dr. Canzek Olga: +386-41824163



NJOFTIMET E ZYRËS SË SHQIPËRISË

• Shqipëri, Tiranë, Reshit Collaku 96.

Fax: +355 4230 535. Drejtori rajonal: Attila Borbath

Drejtori i zyrës: Xhelo Kijaç, tel: +355-4-230-535.

Kontaktim: në ditët e punës në orarin 09.00-13.00, 16.00-20.00



NJOFTIMET E ZYRËS SË KOSOVËS

• Prishtinë, Rr. Uçk br. 94, tel.: +381-38-240-781, +377-44-503-911.

www.flpseeu.com **FLP TV** në internet

Programi i FLP TV nga 24 korrik deri në 21 gusht 2008

06.00-18.00 Himni
06.05-18.05 Ëndrra jote është plani ynë: Hyrje në FLP
06.10-18.10 Levente Bajari, Krisztina Pazar, Roland Csonka: Balet
06.20-18.20 Dr. Eva Szabo Baranyne: Si ortoped në Foreverben
06.40-18.40 Ëndrra jote është plani ynë: Produktet FLP
06.45-18.45 Jozsef Heinbach dhe Dr. Erzsébet Nika: U bëmë senior manager
07.10-19.10 Shadows Hungary Band: Koncert
07.35-19.35 Përmbledhja e ditës së mangerëve
07.40-19.40 Supervisorë, Asistent m...
08.10-20.10 Vlerësimi i shteteve
09.15-21.15 Sunny: Koncert albumprezantues
09.45-21.45 Ëndrra jote është plani ynë: Mundësia FLP
09.50-21.50 Imre Kocsis: Të gjithë kanë një ëndërr
10.25-22-25 Gabor Rath: Trampolini i parë i sistemit tonë marketing
10.50-22.50 Managerë, Managerë drejtues
12.00-00-00 Ëndrra jote është plani ynë: Hyrje në FLP
12.05-00.05 Veronika Nadasi, Attila Serban, Adrienn Szeghő: Pjesë nga musicali me titull Jekyll dhe Hyde
12.25-00.25 Csaba Toth: Po punoj për Profit Scharing
13.15-01.15 Ëndrra jote është plani ynë: Produktet FLP
13.20-01.20 Supervisorë, Asistent m...
13.55-01.55 Pjesë nga musicali me titull Muzika
14.10-02-10 Sundues, Managerë, Targa makinash, man. drejt., Eu.top10, paradë Diamantësh, kualifikim safirësh
16.05-04.05 Borago: Koncert albumprezantues
16.25-04.25 Ëndrra jote është plani ynë: Mundësia FLP
16.30-04.30 Ferenc Tanacs dhe Tanacs Ferencne: Natyrisht me Forever-in
16.45-04.45 Dr. Mariann Diko, Dr. Laszlo Kulicsics: Ruajtja e shëndetit në verë
17.10-05.10 Teri Harangozo, Kati Kovacs, Laszlo Aradszky: Festivali i këngës dhe valles Forever
17.40-05.40 Zsolt Laszlo Geczó dhe Geczó Laszlo Zsoltne: Pavarësia e sistemit marketing



Zyra e Tiranës

Pyetje të ngjashme formohen shpesh në mendjen e ndërtuesve të biznesit pavarësisht nga fakti se janë fillestar apo anëtarë me dituri dhe rezultate serioze.

Që të kuptojmë se mali nuk lëvizet vetëm me forcë, duhet të jemi tepër të hapur. Për shumë prej jush nuk është e panjohur kur them se *Ti tani në jetë ndodhesh aty ku të ka sjellë deritani mënyra jote e të menduarit... Apo ku dëshiron të jesh!*

Nga njëra anë në fillim zakonisht s'e kuptojmë këtë, kurse nga ana tjetër e konsiderojmë të neveritshme. *E si i desha unë kaq borxhe, apo këtë sëmundje, apo të grindesha me atë njeri, apo këtë aksident!*

E di, Ti me të vërtetë nuk ia do të keqen vetes, por mendimet e tua, nëse nuk i kontrollon, ndonjëherë fluturojnë në vende të cilat nuk i përshtaten pamjes së të ardhmes sonë, pasi janë plot me ankth dhe shqetësim. Kurse për ty do të ishte më e thjeshtë të pranoje një fakt që pranohet nga një opinion gjithmonë e më i gjërë, që mendimet kanë forcë krijuese! Universi nuk i cilëson mendimet në të mira apo të këqija, por vetëm i plotëson ato!

Kur merresh me qëllimet e tua dhe ke një ndjenjë të keqe – të cilën e quajmë shqetësim – atëherë plotësohet e keqja. *Se mos bierë shi*, ky lloj mendimi dhe ndjenje është një "prodhues" i shkëlqyer shiu.

E RËNDËSISHME ËSHTË DREJTIMI I MENDIMEVE DHE NDJENJAVE!



Përse ndodh që dikush e ka si lojë, kurse dikush tjetër nuk arrin as në vijën e startit? Ku kemi gabuar në planifikimin e qëllimeve tona? Çfarë duhet më përveç diturisë teknike në këtë biznes? Cili është çelësi i suksesit?

JETA JO GJITHMO

Apo sa mirë do ishte të kualifikohesha si manager këtë muaj. Por më mungojnë edhe 40 pikë, atëherë si do e bëj? S'besoj se mund t'i bëjmë aq pikë.

E the rezultatin përfundimtar! Cili është gabimi? Pas dëshirës doje të gjeje menjëherë mënyrën se si, në vend që të filloje ta bëje, dhe ajo do të vinte vetë. Në vend të kësaj u dorëzove menjëherë!

Dhe nëse ne jemi të qartë me qëllimin tonë dhe na intereson vetëm arritja e tij, atëherë duhet të mësojmë të mos shqetësohemi për mënyrën se si! Nuk është detyra jonë të gjejmë se si do të arrihet, por duhet të dimë vetëm do ta arrijmë!

Ajo që duhet të qartësojmë në radhë të parë është qenia e qëllimeve.

Si është një qëllim i vërtetë?

- E rëndësishme është të krijohet ndjenja pozitive, dhe jo ankth e shqetësim,
- të jetë i yti, e jo i njeriu tjetër,
- kur të mendosh për të, të mos ndjesh mungesën, por kënaqësinë që të shkakton qenia e tij.
- Mos mendo se nga çfarë dhe si, por vetëm dëshiroje! Gjithmonë këtu e prishim, që duam të gjejmë edhe rrugën e realizimit, ndërkohë që ajo nuk është detyra jonë. Atë t'ia lemë në

dorë perëndive, është detyra e tyre!

Të kesh një qëllim për të cilin mund të bësh gjithçka.

Ulu në një cep të qetë dhe kaloje kohën duke imagjinuar se e arrite. Ose VIZUALIZOJE!

S'ka rëndësi nëse bëhet fjalë për një makinë, një fëmijë apo nivelin e shumëpritur të managerit, imagjinoje veten se e ke arritur atë. Përrjetoje deri në pikën kur të shkakton ndjenja **pozitive**.

Përse nevojitet gjithë kjo? Sepse truri nuk mund të bëj ndryshim ndërmjet një përvojë të vërtetë apo "vetëm" të vizualizuar, dhe nëse nisemi nga fakti se mendimet kanë forcë krijuese, atëherë e di përgjigjen.

Po të kuptoni se lënda është energji, dhe mendimi drejton energjinë, kuptoni se gjërat tona i krijojmë vetë ne.

Pastaj është shumë e rëndësishme që t'u lësh fushë të lirë realizimit të dëshirave tua. Ç'dua të them me këtë?

Brenda nesh ndodhen shumë pengesa që na krijohen gjatë jetës, apo sepse na i edukuan gjatë moshës së fëmijërisë, apo sepse u përgjigjemi kërkesave të ndryshme të shoqërisë.

Shpeshherë i habitur shikoj se si njerëzit marrin borxhe për t'u pasuruar me gjëra, me të cilat (sipas tyre) mund t'u ngjajnë njerëzve të cilët as nuk i njohin!

Sipas jush kjo është në rregull?

Ose nëse shoh anën tjetër të krijimit të pengesave, është mirë të ushqesh përditë tiparet apo pamjen negative rreth vetvetes të rrënjosur gjatë muajve dhe viteve?

Derisa mendon se nuk je i aftë për diçka, ajo ashtu mbetet! Duke ndryshuar këtë opinion, ndryshon edhe rezultati.

Cila është detyra jote për të realizuar dëshirat e tua? Ta dish, ta besosh dhe ta ndjesh se Ti e meriton këtë!

Tani do pyesje që kaq e thjeshtë është? Por kujdes, sepse këtu është kurthi, pasi është e thjeshtë nëse ashtu e mendon!

Pra detyrat:

- 1. Gjeji vetes një qëllim të mirë, një dëshirë!**
- 2. Besoje se mund të bëhet e Jotja!**
- 3. Vizualizojë qenien e saj!**
- 4. Dhe natyrisht bëj gjithçka për ta arritur!**
- 5. Zhvilloje veten vazhdimisht!**

Ndihma më e madhe në zhvillimin e vetvetes janë librat, mos e kurse kohën për të lexuar!

Duhet të mësojmë të kemi qëndrim pozitiv ndaj botës, kërkesa pozitive dhe një pamje pozitive të të ardhmes.

Rreth mënyrës pozitive të të menduarit mund të lexosh libra

të shumtë, bëje, sepse e bën për veten dhe mjedisin tënd! Dhe nëse e lexon, përpiku ta zbatosh, pasi ndryshe e gjitha s'ka asnjë vlerë.

Shpeshherë shikoj, mendoj se edhe ti, që lexojmë një libër, në teori e dimë mirë se çfarë qëndrimi duhet të mbajmë ndaj çështjeve, por në praktikë nuk zbatojmë asgjë.

Në këtë mënyrë leximi e humbet kutjimin, bëhet vetëm harxhim kohe!

Atij që ndodhet vetëm në fillim të rrugës që na mëson forcën krijuese të mendimeve, i rekomandoj gjithmonë të lexojë sa më shumë libra me këtë temë.

(Një nga librat e mi të preferuar: *Përrallat Njohëse të Salamonit* i shkruar nga Ester dhe Jerry Hicks. Ky libër e përshkruan aq thjeshtë thelbin, saqë e kupton lehtë edhe një fëmijë!)

Mëso të kesh besim tek vetvetja, mëso të ëndërrosh përsëri, mëso të besosh që këtu merr ndihmë për gjithçka nga sponsori dhe linja jote e sipërme.

Ashtu si unë që kam marrë dhe marr edhe sot e kësaj dite, asnjëherë nuk do e lija pas dore mundësinë për t'ua përmendur juve.

Klara Hertelendy, të cilën e kam sponsore dhe shoqe gjithashtu. Një ëndërruese e vërtetë, e cila ka mësuar shumë prej nesh që jo vetëm duhet ta gjejmë qëllimin, por

TE BËHET

NË E MË E MIRË!

edhe duhet të veprojmë për arritjen e tij.

Hajnalka Senk, e cila gjen rrugëzgjdhjen e duhur për çdo situatë, dhe hidhet në zjarr për skuadrën e vet, për ne. Me rezultatet e saj të vazhdueshme hap rrugën përpara nesh.

Natyrisht gjithë kjo është shumë e rëndësishme, por s'ka asnjë vlerë nëse s'kemi njohuri teknike, kështu që ëndërrojmë dhe mendojmë pozitivisht më kot.

Me siguri edhe ti ke një **Dr. Adolf L. Kosa**, apo një **Tamas Biro** në linjën tënde të sipërme, njohuritë e të cilëve të vijnë gjithmonë në ndihmë.

Ju falenderoj Juve, Klari, Hajni, Adolf dhe Tamas që më pranuat në shoqërinë tuaj dhe më mësuat aq shumë gjëra gjatë këtyre katër viteve.

Ta dish, sepse është e rëndësishme që në sfond, përveç linjës së sipërme, prapa teje qëndron skuadra e Forever-it me në krye drejtorin gjeneral **Dr. Sandor Milesz** dhe përfaqësues drejtorin e Europës **Peter Lenkey**. Ata punojnë vazhdimisht që t'i arrijmë sa më lehtë dhe me sa më shumë rezultat qëllimet tona brenda FLP-s.

Të uroj ta gjesh sa më shpejt **qëllimin** që të vë në lëvizje, dhe nëse a arrin, shiko menjëherë mëtej, sepse ky është çelësi i zhvillimit!

Të uroj të gjesh **skuadrën** për të cilën mund të krenohesh shumë dhe me të cilën mund të rritesh shumë.

Dhe të uroj të gjesh në këtë **lumturi**, sepse pas një farë kohe s'bëhet më fjalë për para!

Shpresoj se të dhashë ndihmë!



GABRIELLA DOMINKO
senior manager



TËRHIQ PAS VETES
NJË BIZNES TË MADH
E TË SUKSESSHËM...

European Rally

Málaga

Spain



26-28 shkurt 2009

Vlera e trainimeve

Si mësues në vitet e kaluara kam punuar me shumë drejtues të FLP-s, kështu që kam patur mundësi të kuptoj punën e ndërtuesve të rrjetit dhe sistemin e trainimeve.



Në lidhje me librin tonë me titull **Udhëzues Personaliteti** i publikuar vitin e kaluar, pata mundësinë të njihesha edhe me Miklos Berkics-in. Pastaj me ftesën e tij bashkë me kolegun tim Krisztian Hackl u prezatuam edhe para publikut të madh në një nga pasditet e "nxjerrjes së shqiptonjave në Lakitelek".

Ky artikull doli sepse kohët e fundit vëmë re një tendencë të veçantë në edukim: ndërkohë që publikohen lëndë përgatitore gjithmonë e më profesioniste dhe mund të ndiqen trainime me nivel gjithmonë e më të lartë, shumë njerëz e kuptojnë gjithmonë e më pak vlerën e vërtetë të diturisë, prandaj edhe nuk shpenzojnë energji të mjaftueshme për përvetësimin e saj.

"Në rregull, ky është çmimi, por cila është vlera? – na shtrohet shpeshherë pyetja kur organizojmë trainime.

Mendoj që punonjës i dashur i Forever-it, edhe Ti ke qenë në situatë të tillë kur i ke rekomanduar një të njohuri apo një fillestari

Ditën e Suksesit, libra, CD dhe DVD. Me të vërtetë çmimi vihet re më lehtë: në një aktivitet çmimi i hyrjes, shpenzimet shiteshin: udhëtimi, me raste ushqimi dhe fjetja, dhe duke mos folur rreth kohës që i kushtojmë. Gjithashtu duhet t'i kushtojmë para dhe kohë leximit, konsultimeve, etj. Pra duket e drejtë dilema: "Përse ia vlen kjo për mua??"

Kjo është një pyetje serioze me të cilën merrem edhe unë "që kur arrita të kuptoj". Afërsisht që nga moshën 12 vjeç kur shoku im i bankës mbidhte katrat e zakonshme në recitim vjershe, pastaj me shumë çiltërsi i drejtohej në këtë mënyrë mësueses së gjuhës: "Çfarë përfitoj unë po ta mësoj këtë?". Për fat të keq atëherë më befaso i aq shumë kjo pyetje, sa që nuk më kujtohet përgjigjja e mësueses (pasi ajo e morri veten). Por ndoshta më mirë kështu, sepse që atëherë i kërkoj përgjigjet.

Duhet të them se dalëngadalë me një përvojë dhjetëvjeçare trainimesh në shkollë të lartë dhe firma private, akoma s'di ta përkufizoj saktë se sa është vlera konkrete e një trainimi, libri, CD-je, etj., por disa gjëra kam filluar t'i kuptoj në lidhje me trainimet...

1. Në radhë të parë nuk është i duhur **shtrimi i pyetjes**. Nuk duhet të pyetet se cila është vlera, por çfarë nuk di akoma, për shkak të të cilës nuk ndodhem aty ku dëshiroj?
2. Nëse dikush ngec për një kohë të gjatë në një nivel, shkakun i saj shpeshherë është që **"ka harruar" të pyesë**. Çdo trainim ka më shumë rezultat nëse jo vetëm ulemi aty, por duam të marrim përgjigje për pyetje konkrete.

"NDODH QË SHKOJMË NËPËR TRAINIME PËR TË SUNDUAR BOTËN, KURSE NË RAST TJETËR QË BOTA TË MOS NA SUNDOJË NE." (W. STONE)

3. Ndodh që nga një aktivitet, konsultim, CD apo libër të mbetet në mendje vetëm **një fjali e vetme**, por ajo mund ta ndryshojë rrënjësisht mënyrën e të menduarit dhe nëpërmjet kësaj gjithë jetën tënde!

4. Vlera e trainimeve **mblidhet**. Pak a shumë kjo funksionon si thyerja e gurit: nëse për ta thyer një shkëmb duhet goditur pesëdhjetë herë, s'është goditja e pesëdhjetë që e thyen, por efekti i përbashkët i gjithë goditjeve.

5. Sa më shumë mëson me **mendje të hapur**, aq më shumë kupton se sa gjëra nuk di – kjo i nxit njerëzit e duhur për të mësuar mëtej. Përshembull kur isha student njëherë u ula në autobus me një vajzë të dashur që studioje për biologji. Natyrisht menjëherë filloi të më interesonte biologjia. Më pyeti se çfarë shikoj pranë rrugës. Pas reagimit tim të pasigurt (bar?) për një orë me radhë shpjegoi se sa lloje bimësh jetojnë aty, kur lulëzojnë, për çfarë mund të përdoren si bimë mjekësore, etj. (Të shtojmë se atëherë nuk e dija se çdo të thotë fjala sanguinik...)

6. Vlera e një trainimi të mirë shpeshherë nuk fshihet vetëm në informacionin e përcjellë, por edhe në faktin se shikon para vetes shembuj për t'u ndjekur, të rritet **vlerësimi i vetvetes**, besimi në sukses apo aftësia e zgjidhjes së problemeve.

7. Edhe trainimi më i mirë "mund t'ju bëhet monoton": pas një farë kohe jemi të prirur për t'u bërë

"imun" në lidhje me ta. Në kohën e herët të bizneseve në rrjet njerëzit shkëmbejnë kasete pirate, kopjoni kopje që mezi dukeshin, udhëtonin me qindra kilometra për në leksione – sepse ishin të etur për dituri. Sot, kur dituria profesionale mund të arrihet lehtë, për shumë njerëz kjo duket e natyrshme. Shikojmë disa drejtues të cilët tashmë **nuk entuziazohen më** nga trainimet, prandaj edhe nuk dinë t'i propagojnë ato në mënyrën e duhur për të rinjtë. Prandaj bie edhe dituria dhe entuziazmi i skuadrës së tyre, edhe rezultati i biznesit...

8. Gjithë kjo mund të shmanget nëse mendon se: një të sapolinduri çdo shaka është e re. Duhet ta përgatisni, ta ndërtoni, pastaj ta zhvillonin trainimin me po atë **pasion** që ndjetë atëherë në "takimin e parë të madh"!

9. Në ruajtjen e pasionit të ndihmon nëse mban gjithmonë në mendje se: një trainim me të vërtetë i mirë sjell **rezultate të mëdha** në kohë dhe hapsirë. Pas një trainimi komunikimi drejtuesish shpeshherë muaj më vonë marrim reagime që personi në fjalë kuptohet më mirë me bashkëshorten dhe fëmijën e tij. Madje çdo njeri i ri në një aktivitet përmban në vetvete farën e një biznesi me përmasa të papara! (Siç e thotë edhe një nga thëniet e mia të preferuara: "Edhe një i metë mund të numëroj se sa fara ka në një mollë, por vetëm Zoti i madh është në gjendje të thotë se sa mollë ka në një farë...")

10. Aktiviteti përgatitor nuk është "cirk" sado që është plot me shaka dhe elemente spektakli! "Atraksioni" i vërtetë s'ndodh asnjëherë në vendgjarrje, por më pas. **Vlerën e vërtetë** të trainimit natyrisht **e jep Ti** me atë për të cilën e shfrytëzon! (Kjo është njëllj e vërtetë edhe për librat e CD-t.)

10+1. Je ai që mendon... Edhe nëse s'do kishin vlerë tjetër, shumica e trainimeve kanë vlerë sepse aty mendjen tënde nuk e sundojnë mendimet negative.

S'është rastësi që edhe një nga lektorët më të njohur të vendit, Emil Tonk, i kushton kësaj teme një CD të tërë! Duke përmendur fjalët e tij: "Ai, për të cilin trainimi është i shtrenjtë, nuk llogarit shpenzimet e paditursisë!" (la vlen ta dëgjosh: Dija është garancia e suksesit edhe në FLP!)

Unë kam si punë dhe hobi gjithashtu të përgatis intervista me drejtues. Si përmbyllje më kujtohet një mendim të cilin e dëgjova jo shumë kohë më parë nga drejtuesi i një skuadre prej mijëra anëtarësh: "Nëse suksesi im ka sekret, ai mund të jetë që deri sot e kësaj dite shikoj në pasqyrë dhe guxoj të shtroj pyetjen që zien brenda meje: Çfarë ndodh nëse nuk do jem unë që kam nevojë për një skuadër më të mirë, por skuadra që ka nevojë për një drejtues më të përgatitur...?"

ZOLTAN NYIRI

Autori është ekonomist i diplomuar, pedagog universiteti, trainer biznesi.

Ai përpunon një nga lëndët trainuese më të njohura të njohjes së vetvetes dhe njërëzve, **Udhëzues Personaliteti**.

www.flpseeu.com

FOREVER 

SHTYPI

Botuese: Kompania Forever Living Products, Hungari. • **Redaktoi:** FLP Magyarországi Kft. 1067 Budapest, Szondi u. 34. Telefon: (36-1) 269-5373 Fax: (36-1) 312-8455 • **Redaktori kryesor:** Dr. Miliesz Sándor • **Redaktor:** Kismárton Valéria, Petróczy Zsuzsanna, Miliesz Anna Sára, Pósa Judit, Pósa Kálmán, Rókás Sándor • **Përgatitja përshtypje:** Tipofill 2002 Kft. • **Grafika:** Teszár Richárd, Buzássy Gábor, • **Fotograf:** Béla Kanyó • **Shtypi:** Veszprémi Nyomda Zrt. U përgatit në 49 250 koje • **Përthyes, redatues:** shqip: Dr. Marsel Nallbani – kroat: Darinka Aničić, Anič Antić Žarko – serb: Tóth-Kása Ottilia, Molnár Balázs, Meseldžija Dragana – sloven: Novak Császár Jolanda, Biro 2000 Ljubljana
Për përmbylljen e artikujve shkruarit mbajnë përgjegjësi! Çdo e drejtë mbrohet!

Pikësnyimi ynë i përbashkët i vendos para një sfide të madhe rrjetndërtuesit e FLP Hungarisë: të jemi të parët në botë. Në shekullin XXI favori më i madh i konkurrencës është nëse skuadra jote mëson më shpejt se sa konkuresit e tjerë (*Peter Senge: The Fifth Discipline – Art and Practice of the Learning organization; përkthim i Dr. Gothard Cs.*).

Duke marrë parasysh këtë FLP Hungaria nga shtatori i 2008-ës nis një seri seminaresh të pavarur (të pavarur nga linjat) duke shfrytëzuar ambientin e qetë dhe të rehatshëm të Hotelit Kështjella e Szirakit.

Kursi i organizuar mirë u siguron pjesëmarrësve zhvillimin e njohurive dhe aftësive të nevojitura për bashkëpunimin me njerëzit.

Vendi i organizmit të seminareve:

Hoteli Kështjella e Szirakit; 3044 Szirák, Petőfi u. 26.

Tematika:

- 1. Jetë ndërmjet Njerëzve të Tjerë** – teknikat e dallimit të aftësive të partnerit bashkëpunues dhe ndikimit më rezultativ të tij. (2x6 orë/2 ditë)
- 2. Strategji të trajtimit të konflikteve** – dallimi i vetëdijshëm i strategjive personale të trajtimit të konflikteve. (2x7 orë/2 ditë)
- 3. Teknika asertive e bisedimit** – strukturimi rezultativ i informacioneve gjatë bisedave ku tregon vetveten. (2x8 orë/2 ditë)
- 4. Zhvillimi i aftësive lektoruere** – përvetësimi i aftësive dhe metodave të prezantimeve motivuese, rikujtuese dhe që të tërheqin vëmendjen. (2x8 orë/2 ditë)
- 5. Teknikë drejtimi sipas situatës** – modeli i komunikimit drejtues rezultativ. Praktikimi i pushtetit motivues. (8 orë/1 ditë)
- 6. Ndërtimi i skuadrës** – vetëm në bazë të matjes paraprake të pjesëmarrësve të projektit të përbashkët.
- 7. Profili i Komunikimit** – dallimi dhe diskutimi i motivimit, mënyrës së sjelljes gjatë trajtimit të konflikteve dhe trajtimit të informacioneve të reja gjatë veprimtarisë së përbashkët.

Regjistrimi

Seminaret i organizojmë në rastin e paraqitjes së të paktën 20 personave. Interesimi dhe regjistrimi mund të bëhet personalisht, në telefon, fax ose e-mail në receptionin e Hotelit Kështjella e Szirakit. Kursi është me pagesë. Çmimi i pjesëmarrjes përmban në vetvete korrigjimin e testeve, konsultimin personal, si dhe shënimet e shtypura.

Takohemi në Szirak!

AKA

SEMINARËT E PAVARUR TË SZIRAKIT



DEMIJA E MJEKËSISË POPULLORE



ZIRAKIT

Në bazë të njoftimeve të menaxherëve dhe bashkëpunonjësve tanë në Kështjellën e Szirakit nisëm kursin 2 vjeçar të mjekësisë popullore. Patëm kërkesa për njohuri më të shumta rreth mekanizmit të shërimit, ndërtimit dhe funksionimit të trupit të njeriut, metodave të ndryshme mjekuese, si dhe rreth sekreteve të mendjes së njeriut.

Kursi i Akademisë së Mjekësisë Popullore që funksionon në Kështjellën e Szirakit nga Shoqata e Mjekëve Popullor Hungarez është një sistem serioz dhe përmbledhës edukimi i cili siguron njohuri të gjera dhe diturinë e nevojshme për provimet zyrtare. Pjesëmarrësit në kurs përvetësojnë njohuritë e domosdoshme për ndërtimin e rrjetit, dhe u japin përgjigje si profesionist me informacionin e gjerë pyetjeve që u lindin konsumatorëve.

Vendi i ororganizimit të kursit: Kështjella e Szirakit, 3044 Szirák, Petőfi u. 26.

Lëndët mësimore: Anatomi, fiziologji, shkenca e ushqimit, ndjenja e gjashtë-radiestezi, reiki, dermato-vakum refleksiologji, masazhe speciale, fitoterapi-terapi aromatike, terapi mikroelementësh, apiterapi, bioenergjitikë ekstrasens, refleksiologji, masazh klasik (suedez), masazh Yumeiho, kineziologji, grafo-psiko-morbo analizë, makrobiotikë, terapi manuale, terapi gjimnastikore, abc-Aloe, numerologji, akupresurë, psikologji, filozofi, drejtësi dhe etikë shëndetësore.

Lektorët: Dr. Istvan Taraczközi, Erzsebet Pal, Dr. Janos Motusz, Dr. Csaba Gothard, Istvan Gillich, Dr. Maria Pataki, Dr. Attila Kiss-Solingen, Peter Paulics, Dr. Edit Revesz, Erika Fodor Bullane, Katalin Horvath, Andras Havasi, Dr. Sandor Rideg, Istvan Sagi, Katalin Takacs, Dr. Istvan Matyas.

Përmbajtja e kursit: Akademia e Mjekësisë Popullore pas çdo kursi jep diploma. Për kursantët e regjistruar sigurojmë një mundësi të jashtëzakonshme edhe për përvetësimin e edukimit shtetëror. Kursi përmban modulën shëndetësor dhe modulën e mjekësisë popullore të nevojshëm për provimin, si dhe kurset bazë të nevojshëm për specializimet e ndryshme.

Kohëzgjatja: Kursi zgjat 2 vjet nga shtatori i vitit 2008. Dy ditë në muaj (e enjta dhe e premtja e parë) janë të zëna.

Shpenzimet e kursit: Kursi i akademisë është me pagesë, çmimi i regjistrimit, i pjesëmarrjes dhe i shënimeve paguhet nga kursanti. Çmimi i kursit mund të paguhet edhe me pjesë.

Informacione të mëtejshme: në faqen tonë
www.termesztogy.webzona.hu

Shoqata e Mjekëve Popullor Hungarez
1023 Budapest, Frankel Leó u. 49. I/3.
Tel: 20/360-9560
E-mail: tgyszov@mail.datanet.hu
www.termesztogy.webzona.hu

Produkt me efekt mjekues që nuk cilësohet si medikament. Efekti i tij vërtetohet nga të dhënat e literaturës profesionale.

Para se të filloni përdorimin e produktit me efekt mjekues, lexojeni me kujdes udhëzuesin e mëposhtëm për pacientin. Ky produkt me efekt mjekues që merret pa recetë mund të mjekojë simptoma të lehta dhe kalimtare pa mbikqyrjen e mjekut. Por për arritjen e efektit optimal është i domosdoshëm përdorimi i kujdesshëm sipas rregullave të produktit. Ruajeni udhëzuesin për pacientin sepse mund të keni nevojë edhe më vonë për informacionet që gjenden në të.



FOREVER GINKGO PLUS®

Cilat janë lëndët vepruese të produktit? 30,33 mg ekstrakt i thatë i gjethes Ginkgo (Ginkgo bilobae folii extr. sicc.), 42,96 mg ekstrakt i thatë i trupit të kërpudhës reishi (Ganodermae lucidi micelium et spora extr. sicc.), 42,96 mg ekstrakt i thatë rrënje Fo-ti (Polygoni multiflori rhizomae extr. sicc.) (2,6:1), 37,66 mg pluhur fruti Schisandra (Schisandrae fructus pulvis), 31,09 mg ekstrakt nativ fruti Schisandra (Schisandrae fructus extr. nativ.) (3-3,25:1) /filmtablettë.

Çfarë përmban produkti? Lëndë ndihmëse: celuloz mikrokristallore, fosfat kalciumi, celuloz, kroskarmeloz natriumi, stearat magnezi. Veshja: acid stearik.

Kur rekomandohet përdorimi i produktit? Për parandalimin dhe mjekimin kryesisht të simptomave të pleqërisë në lidhje me furnizimin e pamjaftueshëm me gjak të trurit, në radhë të parë për përmirësimin e rënies së kujtesës dhe aftësive mendore.

Kur nuk lejohet përdorimi i produktit? Mos e përdorni produktin nëse jeni alergjik ndaj ndonjë lënde vepruese apo ndihmëse.

Çfarë duhet të dini para përdorimit të produktit? Duhet të njihni shkakun e problemeve që trajtoni.

A mund të përdoret produkti nga fëmijët? Produkti nuk mund të përdoret nga fëmijët.

A mund të përdoret produkti bashkë me ilaçe të tjera? Deri tani nuk është parë kundërveprim me ndonjë ilaç tjetër. Nëse ju merrni ilaçe, pyesni mjekun tuaj për përdorimin e produktit.

A mund të përdoret produkti gjatë shtatzanisë dhe dhënies gjii? Në këto situata jete produkti nuk mund të përdoret.

Si dhe kur duhet marrë produkti? Filmtableta duhet marrë pas buke, pa e kafshuar, me pak ujë.

Cila është doza e rekomanduar? Rekomandohet marrja e 2x2 tabletave në ditë.

Çfarë efekti të padëshiruar mund të shkaktojë produkti? Gjatë marrjes së tij mund të keni shqetësime të lehta stomaku, dhembje koke apo simptoma alergjike kalimtare. Nëse dalloni ndonjë efekt të padëshiruar, ndërprijeni marrjen e produktit dhe këshillohuni me mjekun tuaj.

Për çfarë duhet të kujdeseni gjatë marrjes së produktit? Nëse pas marrjes së rregullt për 1 muaj simptomat nuk u përmirësohen, apo ndoshta u keqësohen, drejtojuni menjëherë mjekut! Produkti duhet të mbahet larg nga fëmijët!

Për sa kohë mund të merret produkti? Marrja e produktit në dozën e rekomanduar këshillohet për 1 muaj, por pas përdorimit për 3 muaj rekomandohet kontroll mjekësor.

Si duhet ruajtur produkti? Maksimum në 25°C.

Hapje

Mimoza Borbath dhe Robert Varga
diamant-safir manager - drejtues programi

Përshëndetje

Dr. Sandor Milesz drejtor gjeneral

Përshëndetje

përshëndetja në gjuhën angleze e drejtorit të
Operimit të Europës Peter Lenkey

Program muzikor

Përvojat me produkte të mjekëve

Dr. Endre Nemeth senior manager

Përvojat me produkte të President's Club

Dr. Terezia Samu soaring manager

Program muzikor

Fillova të ndërtoj rrjet

Tamas Biro senior manager

Mundësi e sigurt në dorën tënde

Ferenc Szeplaki manager

Në Shqipëri kushdo mund të bëhet diamant-safir

Aranka Vagasi diamant-safir manager

Edhe unë kështu e fillova si Ju!

Jozsef Szabo safir manager

I urojmë të gjithëve argëtim dhe kalim të mirë kohel!
Mbajmë të drejtën e ndryshimit të programit!

GRAND OPENING

i 14 shtator 2008-ës Shqipëri, Tiranë



more aloe!
DRINK

Pini më shumë aloe!

